

Udhëzues praktikë për prindër/mësimdhënës për **YouTube**




Udhëzuesi përdor pamje reale të aplikacionit dhe shpjegime të shkurtra poshtë tyre.



TikTok: Siguria dhe kontrolli prindëror

Krijoni një përvojë të mbikëqyrur, përcaktoni nivelin e përmbajtjes dhe kufizoni rekomandimet që mund ta mbajnë fëmijën gjatë në aplikacion.

Për fëmijët më të vegjël përdorni YouTube Kids ose një llogari të mbikëqyrur përmes Google Family Link.



1

Hapni Family Center

Hapi 1

Hyni në YouTube me llogarinë e prindit.

²**Hapi 1**


Prekni fotografinë e profilit dhe hapni **Settings**.

Hapi 4

Zgjidhni **Family Center**. Në disa versione më të vjetra mund të shfaqet si **Parental settings**, si në pamjen e mësipërme.

Hapi 5

Zgjidhni llogarinë e fëmijës. Nëse nuk shfaqet, krijoheni ose lidheni më parë në Google Family Link.



2

Zgjidhni llojin e përvojës

Hapi 1

Zgjidhni **YouTube Kids** nëse dëshironi një aplikacion më të thjeshtë, me më pak përmbajtje dhe kontrolle të drejtpërdrejta për fëmijë më të vegjël.



Hapi 2

Zgjidhni **YouTube and YouTube Music (parent supervised)** nëse fëmija është gati për një përvojë më të gjerë, por ende të menaxhuar nga prindi.

Hapi 3

Lexoni paralajmërimin: sistemet e filtrimit nuk janë të përsosura dhe mund të shfaqet ndonjë video e papërshtatshme.





3

Zgjidhni nivelin e përmbajtjes

Hapi 1

Te cilësimet e fëmijës, zgjidhni **YouTube Kids**.

Hapi 2




Zgjidhni nivelin më të përshtatshëm: **Content Settings (Mosha)**.

Hapi 3

Lexoni përshkrimin e secilit nivel; sa më i gjerë niveli, aq më shumë përmbajtje mund të shfaqet.

Hapi 4


Konfirmoni zgjedhjen dhe përfundoni konfigurimin.



4

Ulni shikimin pasiv dhe kufizoni Shorts

- Hapi 1** Te profili i mbikëqyrur, hapni cilësimet e përgjithshme.
- Hapi 2** Çaktivizoni **Autoplay** që videoja tjetër të mos nisë vetvetiu.
- Hapi 3** Nga llogaria e prindit mund të pastroni historinë, të ndaloni ruajtjen e historisë dhe të bllokoni kanale të veçanta për llogarinë e mbikëqyrur.
- Hapi 4** Për YouTube Shorts, kontrolloni **Settings → Time management → Shorts feed limit** nëse ky opsion është i disponueshëm.




5

Aktivizoni Restricted Mode

- Hapi 1** Në aplikacionin YouTube, prekni profilin dhe hapni **Settings** → **General**.
- Hapi 2** Gjeni **Restricted Mode** dhe aktivizoni butonin.
- Hapi 3** Përsëriteni në secilën pajisje ose shfletues ku fëmija përdor YouTube.
- Hapi 4** Mbani parasysh se ky filtër ndihmon, por nuk garanton bllokimin e çdo videoje të papërshtatshme.





6

Kontrolloni dhe menaxhoni aktivitetin

Hapi 1 Në llogarinë e fëmijës, hapni **Profile** → **Settings** → **Manage all History**.

Hapi 2 Te skeda **History**, shikoni videot e hapura dhe përdoreni listën si pikënisje për një bisedë me fëmijën.

Hapi 3 Te skeda **Controls**, mund të ndaloni ruajtjen e videove të shikuara ose të kërkimeve.

Hapi 4 Nga llogaria e prindit në **Family Center**, mund të pastroni historinë, të çaktivizoni Autoplay dhe të ndaloni historinë e shikimit ose kërkimit.

Hapi 5 Mos e përdorni historinë vetëm për mbikëqyrje; flisni me fëmijën për kanalet, reklamat dhe informacionin që ai ose ajo shikon.

Nëse shfaqet përmbajtje e dëmshme

-  Te videoja prekni ⋮ → Report dhe zgjidhni arsyen.
-  Mos e shpërndani videon problematike. Përdorni **Not interested** ose **Don't recommend channel**.
-  Flisni rregullisht për kanalet që fëmija ndjek dhe për mënyrën e dallimit të reklamave, mashtrimeve dhe dezinformimit.